



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:228774

Datë: 27.09.2022

Numri i dokumentit: 03465434

PKR.nr.89/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, Kryetari i trupit gjykues Murat Hulaj, me anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesioniste Arben Mustafaj dhe Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, pas mbajtjes dhe përfundimit të rishqyrtimit gjyqësor me datën 08.09.2022, si dhe pas seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 12.09.2022, në lëndën penale kundër të pandehurit B.R nga Peja, duke vepruar sipas aktakuzës PP/L.nr.204/21 të datës 07.12.2021 të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda të plotësuar nga prokurorja e shtetit gjatë rishqyrtimit gjyqësor me dt. 08.09.2022, duke propozuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim në institucionin e shëndetit mendor, në prezencën e Prokurores së Shtetit Valbona Disha-Haxhosaj, të pandehurit B.R si dhe mbrojtësit i tij av. Azdren Mekaj, si dhe Përfaqësuesi i viktimave S. S., e në mungesë të të dëmtuarit S. B., i ftuar në mënyrë të rregullt, me dt. 12.09.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 27.09.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.R, i biri i S. dhe nënës F. e gjinisë L., i lindur me dt. data e lindjes në Pejë, me vendbanim në lagjen A. në Pejë, me profesion kamarier në qebaptoren “A.” në Pejë, beqar, analfabet, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. personal..., posedon numër të telefonit ../..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet nën masën e paraburgimit dhe atë nga dt. 11.10.2021 e tutje,

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SË:

I. Se me ditën 11.10.2021 rreth orës 1:55 min në Pejë, në Q. të gjate, afër Xh. duke vepruar në gjendjen të aftësisë së zvogëluar mendore, me dashje dhe me armë dhe atë me pistoletëkalibër ..mm, me nr. serik ka tentuar të privoj nga jeta S. B., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri pasi takohet me të dëmtuarin rreth orës 15:00, ky i fundit i thotë të pandehurit “A donë me votua në këto zgjedhje për G. e ...-së”, kurse i pandehuri i drejtohet “Ti

e din se unë nuk e ndërroj askënd përveç R. H.”, pastaj i pandehuri vazhdon rrugën për në punë në qebaptorë “Të A.”, kur shkon në punë fillon të ndihet keq për shkak të pyetjes që ja kishte bërë i dëmtuari, me çrrastë nga një dollap e merr armen e të cilën e kishte fshehur nga pronari i qebaptores “Të A.”, dhe më të njëjtën kohe prape tek i dëmtuari i cili në ato momente kishte qenë se bashku me një punëtorë duke i fut sendet më kiosk, dhe posa i afrohet të dëmtuarit i pandehuri e gjuan një here në drejtim të dëmtuari duke plagosur në abdomen, ku i dëmtuari rrezohet në tokë, kurse i pandehuri fillon me ik nga vendi i ngjarjes, ku gjatë ikjes i pandehuri gjuan edhe dy herë në drejtim të dëmtuarit ku copëzat e predhës e kapin të dëmtuarin në anën e majtë në shpinë, e të cilën më pas e marrin disa kalimtarë të rastit dhe e dërgojnë në Spitalin e Pejës e nga aty në QKUK në Prishtinë,

- Me çka ka kryer veprën penale vrasje e mbetur në tentativë në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore në shkallë esenciale nga neni 172 lidhur me nenin 28 e lidhur me nenin 18 par.2 të KPK-së

II. Me parë e gjerë më datën 11.10.2021 rreth orës 17:55 min, në Pejë, pa autorizim ka mbajtur në kontroll dhe posedim armën dhe atë Pistoletënkalibër .. mm, numër serik dhe një karikator të zbrazë, në atë mënyrë që me të njëjtën armë ka kryer veprën penale të cekur si në dispozitiv e parë të këtij aktvendimi .

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par .1 të KPK-së.

Gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 4, 7, 8 par. 1, 18 par. 2, 38, 39, 40 par. 1 pika 1.2, 42, 69, 70, 71, 72, 76, nenit 172 e lidhur me nenin 18 par.2, dhe nenit 366 par. 1, të KPRK-së, nenit 365, 366, 367 par. 1, pika 1.1 dhe par. 3 dhe par. 7, 370 të KPRK-së, të akuzuarit,

I përcakton

- Për veprën penale nga pika I, “Vrasje e mbetur në tentativë” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe nenin 18 par. 2, të KPRK-së, i përcaktohet dënimi burgimi prej 3 (tri) vjet burgimi.
- Për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së, i përcaktohet dënimi 3 (tri) muaj burgim

Pas unifikimit të dënimeve konform nenit 76 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin B.R e:

G J Y K O N

I. Me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe 1 (një) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim.

II. Në dënimin e shqiptuar konform nenit 79 par. 1, të KPRK-së i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt. 11.10.2021 e tutje.

III. Të pandehurit B.R në kuptim të nenit 367 par. 1 pika 1.1 dhe par. 3 dhe par. 7 të KPPRK-së, i vazhdohet paraburgimi, dhe atë nga dt. 12.09.2022 e deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar. Për këtë gjykata do ta sjelle aktvendim të veçantë.

IV. Në përputhje me nenin 453 par. 4, të KPPRK-së i akuzuari lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale për shkak të gjendjes së vështire ekonomike.

V. Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së, ndaj të pandehurit B.R i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET një (1) arma pistolette e markës “C. Z”, model .., kalibër ..x..mm, me nr. serik dhe një karikator i zbrazet i dizajnuar për pistoletat “C Z”, model .. dhe e njëjta ka për tu **SHKATËRRUAR** pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, duke u thirru nen numrin e rastit policor të DRP – Sektori i hetimeve-DA-... dhe ...-HRP-....

VI. Pala e dëmtuar S. B. udhëzohet ne kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Gjykata duke u bazuar në nenin 83, paragraf 1 dhe 2, nenin 84 paragraf. 1 nën paragraf 1.1 nenin 85 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe neneve 513, 514 nën paragraf 3.1, 3.2, 3.3 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit krahas dënimit të shqiptuar si më lartë, i shqipton edhe:

MASA E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUTIN E PSIKIATRISË FORENZIKE TË KOSOVËS NË PRISHTINË

S H Q I P T O N

- 1. MASËN E TRAJTIMIT DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË NDALIM, pranë QKUK - Repartit të institutit Psikiatrik të Fornezikës në Prishtinë e cila do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**
- 2. Reparti i institutit Psikiatrik të Fornezikës në Prishtinë obligohet që të pranojë dhe trajtojë në pikëpamje psikiatrike të pandehurin B.R.**
- 3. Reparti i institutit Psikiatrik të Fornezikës në Prishtinë, obligohet që në periudha 6 (gjashtë) mujore, ta njoftoj me raport të veçantë Gjykatën Themelore në Pejë, për ecurinë e trajtimit të obligueshëm psikiatrik të pandehurin B.R.**
- 4. Urdhërohet Njësi i transportin e të burgosurve në Lipjan, si dhe Qendra e Paraburgimit në Pejë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të pandehurin ta transportojnë në QKUK – IPFK në Prishtinë për trajtim.**
- 5. Masën e shqiptuar si nën I, të këtij aktgjykimi, gjykata do ta pushojë kur të vërteton se ka pushuar nevoja për trajtim në repartin e psikiatrisë.**

6. **Koha e pritëshme-ardhëshme, që do mbahet në trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim pranë QKUK - Repartit të institutit Psikiatrik të Fornezikës në Prishtinë, e cila do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas pikës I. të dënimit të unifikuar.**

Arsyetim

Historiku i rastit

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 204/21 e datës 07.12.2021 kundër të pandehurit B.R nga Peja me dyshimin e bazuar mirë se ka kryer veprat penale, “Vrasje e mbetur në tentative”, nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 18 par. 2, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së.

Gjykata me aktgjykimin e dt. 25.02.2022 të pandehurin ka shpall fajtor për shkak të veprave penale të lartcekura dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim unik burgimi prej tri 3 vite dhe një 1 muaj.

Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj PAKR Nr. 187/2022 dt. 29.04.2022 ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore Në Pejë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim për shkak të arsyrave të cekur në Aktvendimin PAKR.nr.187/2022 dt.29.04.2022, të Gjykatës së Apelit, në vlerësim të Aktgjykimit të ankimit me numër PKR.nr.198/2021 dt. 25.02.2022, duke sugjeruar se nuk ka vrasje pa *dashje*, e që këtë fjalë të fundit prokurorja e kishte eliminua para se të lexonte akuzën në shqyrtimin fillestar të dt. 10.02.2022.

Shqyrtimi kryesor

Gjykata me dt. 08.09.2022 ka mbajtur seancën e rishqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezentë Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri B.R, mbrojtësi i tij, av. Asdren Mekaj i caktuar sipas detyrës zyrtarë, eksperti i neuropsikiatrisë dr. J. Z., mbrojtësja e viktimave nga ZMNV – Pejë S. S., ka munguar i dëmtuari S. B. edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, të dhëna në aktvendimin e kësaj të fundit nën shenjen PAKR Nr. 187/2022 dt. 29.04.2022 ka ftuar Prokuroren e Shtetit që ta eliminojë të metat nga dispozitivi i parë, që ka të bëjë me veprën penale “Vrasje e mbetur në tentative” e kryer në gjendjen e aftësisë së zvogëluar mendore.

Prokurorja e Shtetit ka deklaruar se: *unë bëj përmirësimin e dispozitivit të parë të aktakuzës dhe atë vetëm sa i përket dashjes, ku në aktakuzën e dt. 07.12.2021 e kam konstatuar dashjen mirëpo që në shqyrtimin fillestar e kam heq. Tani duke ju referuar sugjerimeve të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PAKR Nr. 187/2022 dt. 29.04.2022 unë mbes në tërësi pranë përshkrimit faktik të cekur në aktakuzë me dt. 07.12.2021 pa ndonjë ndryshim, qëndroj në tërësi pranë aktakuzës të dt. 07.12.2021.*

E njëjta po ashtu ka shtuar se edhe propozimin shtesë që ndaj të pandehurit B.R krahas dënimit, të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e shëndetit mendor nga neni 85 par. 1 pika 1.1 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së.

Dëgjimi i ekspertit të neuropsikiatrisë

Gjykata, para se ta fton të pandehurin që të deklarohet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë, fillimisht ka marrë në pyetje ekspertin e neuropsikiatrisë Dr. J. Z., i cili ka qenë i kyçur në këtë çështje penale që nga fillimi, i cili se bashku me ekipin e eksperteve ka trajtuar të pandehurin B.R, i cili është njëri prej përpiluesve të ekspertizës psikiatrike dhe i cili fillimisht ka ekzaminuar të pandehurin.

I njëjti gjatë seancës ka deklaruar së: *sa i përket pjesëmarrjes se tij ne seance pas konsultimit paraprak që kemi bërë, i njëjti mund të merr pjese në seance, mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, e kupton procedurën gjyqësore që zhvillohet ndaj tij si dhe deklaratat e tij të dhënë sot ne gjykatë janë valide, dhe vërehet përmirësimi i gjendjes se tij. Po ashtu i njëjti është ne gjendje të kuptoje benefitet të pranimit të fajësie apo penalizimit të tij si dhe pasojat e pranimit të fajësie, ndërsa sa i përket ekspertizës të dt. 24.11.2021 mbetet ne tërësi pranë mendimeve të dhëna në lidhje me të akuzuarin B.R. Sa i përket plotësimit e bërë nga ana e PSH për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik ne institucionin e shëndetit mendor me ndalim, mendon që ka nevojë për përkujdesje nga profesionistet e shëndetit mendor ne mënyrë që gjendja e tij të përmirësohet e që mos të përsëriten veprat të tilla si pasoje i këtij çrregullimi. Ne rastin konkret kemi të bëjmë me një episode akute të një çrregullimi psikotik e që çrregullimi është qe mund të përfundoje me një epizode të vetëm mirëpo është e nevojshme që të përcillet, te monitorohet nga ana e profesionisteve të shëndetit mendor siç është psikologu, psikiatri dhe stafi tjetër mbështetës. I njëjti po ashtu ka sqaruar se kemi të bëjmë me një çrregullim akut që është apo mund të jetë epizode e çrregullimit psikotik, që mund të përfundojë me vetëm këtë epizode dhe të mos përsëritet, mirëpo gjithmonë ekziston një rrezik që kjo epizode te kaloje ne çrregullim kronik marr për baze që gjenetika te shumica e problemeve të natyrës së tillë është e rëndësishme, ne rastin konkret sipas të dhënave të dhëna nga ana e familjareve, edhe nena edhe vëllai kane çrregullime kronike të natyrës psikikë, prandaj për këtë arsye ka nevojë që të përcillet me vizita të rregullta nga ana e psikiatrit.*

Eksperti tutje ka deklaruar se: *si ekipi vlerësues gjatë kohës së vlerësimit ku ka qene i pandehuri për afërsisht një muaj, i njëjti ka qëndruar në Institut dhe gjate kësaj kohe ka filluar trajtimin ku i njëjti ka përdorur terapinë, po ashtu edhe gjatë pjesëmarrjes së tij si ekspert në seanca të intervistimit në Prokurori si dhe në seanca gjyqësore, vërehet se gjendja e tij është dukshme e përmirësuar në raport me kohën kur është kryer vlerësimi. Ndërsa sa i përket ditës kritike për veprën për të cilën akuzohet, për shkak të natyrës së sëmundjes ka ardhur deri të përkeqësimi i situatës dhe aftësia e tij mendore për ta kuptuar rëndësinë dhe pasojat e veprimeve te tij ka qenë e zvogëluar në shkalle esenciale, pasi që, ne baze te të dhënave që kanë poseduar si ekipi vlerësues, kemi një fillim të shpejt të epizodes psikotike dhe e cila zgjatet një muaj e më shume ditë dhe që është i nevojshme që të trajtohet dhe ta përdor terapinë e përshkruar nga ana e psikiatrit. Mirëpo sa i përket përgjegjësisë ne shkalle jo esenciale personat e tilla kane diagnoza psikiatrike, kane raporte të trajtimit mirëpo ato diagnoza nuk e hudhin përgjegjshmërinë për veprat kur bien ndesh me ligjin, ndërsa përgjegjësia e zvogëluar ne shkalle esenciale mund të ekzistojë mirëpo diagnoza psikiatrike dhe ndikimi i tyre ne gjendjen psikike e ulë përgjegjshmërinë, por nuk përjashton përgjegjësinë.*

Deklarimi i të pandehurit në lidhje me fajësinë

Pas kësaj, e duke pas parasysh deklarimin e ekspertit të neuropsikiatrisë si më lartë, i cili gjatë seancës deklaroi se i pandehuri mund të merr pjese ne gjykim, se mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, se e kupton procedurën gjyqësore dhe se deklaratat e tij janë valide, ka ftuar të

njëjtin që të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë, duke e njoftuar fillimisht për të drejtat dhe detyrimet e që i takojnë me ligj, e po ashtu për kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë sipas dispozitave përkatëse ligjore.

I pandehuri B.R pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka deklaruar se: *e pranoj fajësinë për veprën penale nga pika I dhe II të aktakuzës, unë jam i penduar për këto vepra penale, më parë nuk kam pas asnjë rast, me vjen keq që ka ndodhur, shpreh keqardhje edhe një here edhe pse i dëmtuari nuk është këtu, dhe këtë e kam shpreh edhe ne seancat e mëparshme, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla.*

Prokurorja e shtetit ne lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri ne mënyrë vullnetare, pa presion e ne konsultim me mbrojtësin e tij pranoi fajësinë unë propozoj gjykatës që ta aprovoj meqenëse një pranim i tille është i mbështetur ne prova ne baze të te cilave është ngritur aktakuza me propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ne ndalim.*

Përf. e viktimave nga ZMNV – Pejë, S. S. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë. Sa i përket dëmit, pala e dëmtuar ka qene e njoftuar dhe nuk ka prezantuar ndonjë kërkesë pasurore juridike ne zyrat tona.*

Mbrojtësi i të pandehurit B.R, av. Asdren Mekaj ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse nga Prokuroria u propozua masa shtese, krahas dënimit kryesor, e ne bazë të deklarimeve edhe të ekspertit konsiderojmë se janë arritur pretendimet tona. Pranimi i fajësisë është i bazuar edhe ne shkresat e lendes e gjithashtu i mbrojturi im nuk e kundërshton veprime te tij, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovon pranimin e fajësisë.*

Pas kësaj, trupi gjykues fillimisht ka vlerësuar se pranimi i fajësisë a është bërë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 326 e lidhur me nenin 248 par. 1 pika 1.1 deri 1.4 të KPPRK-së. Trupi gjykues ka gjetur se ky pranim i fajësisë është shprehja e vullnetit të lire te të pandehurit, po ashtu ka mbështetje ne shkresat e lëndës dhe së është bërë konform dispozitave të cekura si më larte, është në përputhje me të gjitha provat të cilat gjenden ne shkresat e lëndës, siç janë: *Raporti- ekspertiza psikiatrike për gjendjen e shëndetit mendor te pandehurit B.R me nr. 540/2-7 të dt. 02.12.2021 i punuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr.2021-DA-.. dhe 2021-HRP-.. dt.08.11.2021 së bashku me listën e dëshmimeve dhe foton e 3 copëzave të plumbit të nxjerra nga ana e majtë e shpinës se te dëmtuarit S. B., raporti i ekspertimit AKF/2021-.../2021-... dt.04.11.2021, fletë lëshimi me epikriz i lëshuar nga QKUK- Prishtinë –Reparti Klinik i Kirurgjisë abdominale me nr. të amzës ... dt.19.10.2021, raporti i policit hetues H. R. me nr 2021-DA-.... dhe Ref 2021-HRP-... dt.19.10.2021 së bashku me një CD me video inqizime të nxjerrura na kamera e auto shkollës “L.” rr.”B. K.” – Pejë, raporti i policit hetues H. R. me nr të rastit 2021-DA-. e dt.15.10.2021, raproti i policit hetues H. R. me numër te njëjtë dt.15.10.2021, raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes, foto albumi i vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, raporti i oficerit A.Sh. dt.11.10.2021, raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes me dt. 12.10.2021 së bashku me foto albumin e vendit të ngjarjes dhe CD-në me video inqizimin e kamerave të marra në vendin e ngjarjes në q. të gjatë, raporti i oficerit G. K. dt.11.10.2021, raporti i oficerit K. Z. e dt. 11.10.2021, raporti i oficerit A.Sh. dt.11.10.2021, raporti i policit hetues K. K. dt. 11.10.2021, raporti i policit Z H. R. dt.12.10.2021, vërtetimi mbi sekuterimin e përkohshëm te sendeve- armës- një pistoletë Z M-..., kalibër mm me një karikator të zbrazët dt.12.10.2021 së bashku me foton e armës, raporti mjekësor Dr. M. H. dt.12.10.2021, si dhe shkresat e tjera te lëndës, dhe për këtë ka marrë Aktvendim procedural me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana*

e të pandehurit B.R, për veprat penale “Vrasje e mbetur në tentative” e kryer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në shkallë esenciale, nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe 18 par. 2 të KPRK-së si dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim i paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Fjala përfundimtare e palëve

Meqenëse i pandehuri B.R ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, dhe pasi ky pranim i fajësisë u aprovua nga trupi gjykues, gjykata në kuptim të nenit 326 par. 4 të KPRK-së¹, ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve në procedure.

Prokurorja e Shtetit ne fjalën përfundimtarë ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, e të cilin pranim e ka bere ne mënyrë vullnetare ne konsultime me mbrojtësin e tij, unë mbes ne tërësi pranë aktakuzës, përshkrimit faktik dhe juridik të veprave penale, propozoj gjykatës që të akuzuarin të shpall fajtor, ta dënon sipas ligjit si dhe ti shqiptojë masën e propozuar nga Prokuroria krahas dënimit. Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim i propozoji gjykatës që si rrethane lehtësuese gjykata ta vlerësoj pranimin e fajësisë, e të cilin pranim i pandehuri e ka bërë ne të gjitha fazat e procedurës, pendimin e tij, kushtet shume të vështira ekonomike, gjendjen psikikë ashtu te konstatuar nga eksperti i psikiatrisë kurse si rrethana renduese përveç pasojave të renda të cilat janë shkaktuar të dëmtuarit dhe këto pasoja janë të përhershme, prokuroria nuk ka gjet ndonjë rrethane renduese.*

Mbrojtësja e viktimave nga ZMNV – Pejë ka deklaruar se: *e mbështes fjalën përfundimtare e Prokurores.*

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Asdren Mekaj ka deklaruar se: *me rastin e pranimit të fajësie mu me mbetet vetëm që ta propozoj gjykatës që me rastin e marrjes se vendimit mbi të dënimin ta merr mendimin e ekspertit lidhur me gjendjen e tij shëndetësore ne kohen e kryerjes se veprës penale, gjendjen e rëndë ekonomike, nevojë për trajtim me ndalim, si dhe ti shqipton një dënim me të butë.*

I pandehuri B.R ka deklaruar se: *pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim, unë kam edhe një fjale, unë nuk do ta përsëris më kurrë veprimet e tilla, kurrë nuk kam pas probleme me askënd, unë po përdori terapinë, dhe qysh me thëni ju ashtu do ta veproj.*

Gjendja e vërtetuar faktike

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për dy vepra penale që i vihen në barrë është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Vrasje e mbetur në tentative” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 e nenin 18 par .2 e përmirësuar ne seancën e shqyrtimit fillestar të dt. 13.01.2022 dhe për vepër penale “Mbajtje ne pronësi, posedim ose kontroll të paautorizuar” të armeve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Përgjegjësia penale e të akuzuarit

¹ Kur trupi gjykues vlerëson se kërkesat nga neni 248, paragrafi 1. i këtij Kodi janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën përfundimtare të palëve.

Në këtë çështje penale, prej fillimit ka qenë problematike përgjegjësia penale e të akuzuarit B.R. I njëjti, siç është cekur me lartë dhe ne bazë të pranimit të tij të fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, ne Polici, në Prokurori dhe në Gjykate ka kryer veprat penale nga dispozitivat I dhe II të këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar përgjegjësinë e tij penale, gjykata ka marrë për bazë Ekspertizën psikiatrike e urdhëruar nga Prokurori i Shtetit dhe e kryer nga ekipi i eksperteve në Institutin e Psikiatrisë forenzike të Kosovës. Ekipi i eksperteve i përbërë nga dr. J. Z., Dr. A. G. dhe dr. B.O., pas ekzaminimit e të pandehurit, ne akt ekspertimin dhe mendimin të tyre përfundimtar kane cekur se:

- *Të i ekzaminuari është evidentuar diagnoza Çrregullim akut psikotik, që në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD-10) kodohet me F23.8*
- *Ky çrregullim ka fillim të shpejte ku përfshijnë të paktën një simptomë madhore të skizofrenisë, labilitet emocional, çrregullim i vëmendjes, sjellje të çuditshme, sjellje bizare dhe konfuzion.*
- *Sa i përket ditës kritike, ne momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, për shkak të specifikave të sëmundjes, ka ardhur deri të përkeqësimi i sëmundjes baze, andaj aftësia e tij mendore për të kuptuar rëndësinë e veprës si dhe kontrolli ndaj veprimeve ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale.*
- *I njëjti mund të marrë pjesë në procesin gjyqësor, mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, i kupton procedurat gjyqësore që janë duke u zhvilluar ndaj tij, por të dhënat e tij mund të jenë të shtrembëruara apo dëmtuara për shkak të natyrës së sëmundjes së tij.*

Andaj, duke u bazuar në këtë ekspertizë të psikiatrisë dhe në të gjeturat e ekipit të eksperteve, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri ka qenë ne gjendjen e **përgjegjësia se zvogëluar esencialisht në kohën e kryerjes së veprës penale**, e parashikuar me nenin 18 par. 2 të KPRK-së. Sipas këtij neni, personi që ka kryer veprën penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar a kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij, ka qenë e zvogëluar dukshëm. Tutje, personi i cili vepron ne gjendjen e përgjegjësia se zvogëluar esencialisht në kohën e kryerjes së veprës penale është penalisht përgjegjës, por mund të dënohet më butë.

Rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese

Kryetari trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese të përcaktuara e të përmendura - konfirmuara nga ana e prokurorit gjatë seancës e të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ne të gjitha fazat e ka bërë pranimin e fajësisë, i njëjti ka kërkuar falje për veprimet e tij, dhe ka deklaruar së është penduar thellë, ka kërkuar falje të dëmtuarit edhe pse ky i fundit nuk ishte ne seance të shqyrtimit gjyqësor, provokimin e bërë nga i dëmtuari ndaj të pandehurit sa i përket mendimit politik për votim, rrethanat psikofizike të cilat kanë ndikuar tek i akuzuari për ta kryer veprën penale ne gjendjen e zvogëluar në shkallë esenciale si dhe rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar siç janë kushtet e vështira ekonomike në të cilat i pandehuri

jeton, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata gjeti se i njëjti ka kryer veprën penale duke rrezikuar edhe personat të tjerë – kalimtarët e rastit.

Mbi këto rrethana gjykata ka pasur për bazë gjendjen e tij, në momentin e kryerjes së veprës penale dhe si të tilla i ka vlerësuar me rastin e matjes se lartësisë së dënimit duke pas parasysh ndëshkueshmëria për veprën penale të vrasjes nga pika I, e dispozitivit të aktgjykimit është e dënueshme më jo më pak se pesë vjet burgim e gjerë në 25 vjet, përderisa për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, parasheh durueshmërinë me gjobe deri në 7500 euro ose dënim me burgim deri në pesë vjet ashtu që për veprën e parë penale duke aplikuar dispozitat për zbutjen të dënimit ka shkuar nder minimumit ligjor të parashikuar për veprën penale të vrasjes, ka aplikuar kufijtë e zbutjes së dënimit nga neni 71 par. 1, pika 1.3 dhe 72 par. 1, pika 1.2, ku përcaktohet se për veprat penale për të cilat është parapare dënimi më i ulët prej pesë viteve, dënimi mund të zbutet deri në 3 vjet burgim, dhe si të tilla në rastin konkret e ka aplikuar marr parasysh edhe gjendjen emocionale momentale të kryesit, përderisa për veprën nga pika II, e dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku minimumi ligjor është minimumi i përgjithshëm të dënimit me burgim prej 30 ditëve.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të elaboruara me sipër, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim, i pandehuri do ta kuptojë rëndësinë e veprave të kryera penale dhe në këtë mënyrë i njëjtit do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktojë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejë vepra penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së. Gjykata i shqiptoi një dënim unik me bindjen e plote se Gjykata se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, dhe po ashtu në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi sanksionin penal dhe masën trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

Gjykata krahas aktakuzës ka pasur edhe propozimin për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e shëndetit mendor, dhe atë konform propozimit të Prokurores së Shtetit drejtpërsëdrejti në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt. 08.09.2022. Kjo për faktin se nga ekspertiza e psikiatrisë e përpiluar nga IPFK pranë QKUK – Prishtinë, si dhe në bazë të mendimeve të dhëna nga ana e ekspertit Dr. J. Z. në seancë, rezulton se të i pandehuri është evidentuar diagnoza e quajtur *Çrregullim akut psikotik*, i cili kodohet me shifrën F23.8 sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve.

Andaj, Gjykata krahas dënimit të shqiptuar kundër të akuzuarit, ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, pasi që ka vlerësuar se ky propozim është i bazuar, dhe së është në përputhje të plote me nenin 85 të KPRK-së, duke pas parasysh gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit dhe ka mbështetje edhe në provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata, duke marrë për bazë rrethanat dhe gjendjen e të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale, si dhe çrregullimin mendor nga i cili ai vuan, e i cili çrregullim është konstatuar

nga ekipi i eksperteve, dhe po ashtu edhe rekomandimet dhe propozimin e ekspertit Dr. J.Z., ka gjetur se është e domosdoshme që të njëjti ti shqiptohet edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Kjo me qëllim që i njëjti të rehabilitohet, dhe në këtë mënyrë të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, që i njëjti mos të kryejë vepra penale, të mos jetë i rrezikshëm për rrethinë ku jeton dhe në këtë mënyrë të eliminohet rreziku i përsëritjes së veprave penale.

Gjykata është e mendimit se me zbatimin e kësaj masës i njëjti do të përcillet dhe trajtohet nga ana e eksperteve të lemisë përkatëse dhe se gjendja e tij, mund të përmirësohet edhe më tej. Si një fakt posaçërisht i rëndësishëm, gjykata ka gjetur edhe gatishmërinë dhe motivin që e ka shfaqur edhe vet i pandehuri për rehabilitim, dhe këtë e mbështes në deklarinimin e tij së **“unë po përdori terapinë, dhe qysh me thëni ju ashtu do ta veproj”**.

Gjykata në rastin konkret zbatoi nenin 18 par. 2, të KPRK-së² si dhe nenin 515 par. 1, të KPPRK-së³, ku neni 515 par. 1 udhëzon në nenet 88 dhe 89 të KPRK-së, e të cilët nene janë identike me dispozitat e neneve 85 dhe 86 të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës.

Nga dispozitat e lartcekura vijmë në përfundim se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës, pra i njëjti gjykohet për veprën penale të cilën e ka kryer në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore në shkallen esenciale, por një gjendje tillë merret parasysh kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Tutje konform nenit 515 paragrafi 1 të KPPRK-së, gjykata krahas aktgjykimit ndaj personit me aftësi të zvogëluar mendore, shqiptoi edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e shëndetit mendor, respektivisht IPFK në Prishtinë, pasi që me këtë dispozitë është paraparë mundësia që krahas aktgjykimit dënues gjykata të shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Andaj gjykata konsideron se shqiptimi i një mase të tillë, është i domosdoshëm për të arritur tek rehabilitimi i të pandehurit në mënyrë që i njëjti mos të përsëris veprimet e tilla.

Gjykata me rastin e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet nga neni 85 par.1, nën par.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, kështu që duke marr parasysh të gjeturat nga ekipi i eksperteve të IPFK-së, si dhe rekomandimet që rezultojnë nga ekspertiza e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, dhe po ashtu sqarimet e dhëna në seancë nga Dr. J. Z., gatishmëria dhe vullneti i të pandehurit për tu trajtuar, dhe mundësia që përmes këtij trajtimi që i njëjti të rehabilitohet dhe kështu të vazhdon jetën e tij, kanë bindur këtë gjykatë se kjo masë është e domosdoshme, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfundimi

² *Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/saj ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.*

³ *Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal,*

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha të cekurat më lartë, gjykata fillimisht i përcaktoi dënimin të pandehurit për veprat penale si në dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimi.

Pas kësaj, në përputhje me nenin 76 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 të KPRK-së, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin e unifikuar për bashkimin e veprave penale.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim të të pandehurit në dënimin e shqiptuar është marrë konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit është marrë në përputhje me nenin 367 par. 1 pika 1.1 dhe par. 3 dhe par. 7 të KPRK-së dhe për këtë ka marrë aktvendim të veçantë pas shpalljes së aktgjykimit burimor dhe të njëjtin ka ekspeduar palëve.

Vendimi mbi lirimimin nga pagesat e shpenzimeve të procedurës penale të pandehurit B.R është marrë në kuptim të nenit 453 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësuese - konfiskimin e armës dhe shkatërrimin e saj, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitës së nenit 463 të KPRK-së, të dëmtuarin S.B., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzon në kontest të rregullt civil.

Po ashtu, gjykata konform dispozitave të nenit 83, 84 dhe 85 të KPRK-së e lidhur me nenin 515 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim e cila do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe njëkohësisht ka obliguar Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë që të pandehurin ta pranojë, ta trajtojë si dhe ta raportojë në periudha gjashtëmujore për ecurinë e trajtimit të tij.

Në kuptim të nenit 85 par. 2 të KPRK-së, gjykata masën e shqiptuar të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim do ta pushojë kur vërteton se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Në kuptim të nenit 85 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 515 par. 3 të KPRK-së, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do t'i llogaritet në kohën e dënimit të shqiptuar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Nëse koha e mbajtur në ndalim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik është më e shkurtër se dënimi me burgim, gjykata mund të urdhërojë që kryesi të dërgohet në burgim për të mbajtur pjesën mbetur të dënimit ose gjykata mund të urdhërojë lirimimin me kusht. 85 par 3

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 dhe nenit 515 par. 1 të KPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.89/22 dt. 27.09.2022

Zyrtari ligjor,

Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,

Murat Hulaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.